



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.960/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përbarimore të kreditorit Auto Mita SH.P.K, me numër unik identifikues: 810816481, me adresë Rr. Magjistralja Prishtinë Shkup-fshati Perocë, Prishtinë, kundër debitorit DT MINING SH.P.K, me numër unik identifikues: 811287350, me adresë Rr. “Hajrullah Abdullah”, nr.30 Bregu i Diellit, Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.357/21 të datës 03.09.2021 të Përbaruesit Privat Rezarta Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 17.10.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit DT MINING SH.P.K me numër identifikues: 810816481, dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri për lejimin e përbarimit P.nr.357/21, të datës 03.09.2021, i lejuar nga Përbaruesi Privat Rezarta Metaj, me seli në Prishtinë, për pjesën sa i përket detyrimit kryesor në shumën prej 2,859.20 Euro.
- II. MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit për lejimin e përbarimit P.nr.357/21, i datës 03.09.2021, i lejuar nga Përbaruesi Privat Rezarta Metaj, me seli në Prishtinë, me të cilën është caktuar përbarimi, sa i përket shpenzimeve të procedurës përbarimore dhe kamatës.
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përbarimore e kreditorit Auto Mita SH.P.K, ndaj debitorit DT MINING SH.P.K, sipas Urdhrit Përbarimor P.nr.357/21, të datës 03.09.2021, për detyrimin kryesor në shumën prej 2,859.20 Euro për shkak të përmbushjes së detyrimit kryesor.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat Rezarta Metaj, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Auto Mita SH.P.K, ka caktuar urdhrin P.nr.357/21 të datës 03.09.2021, duke lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturave nr.21-SHV01-V-102 e datës

15.06.2021, dhe nr.21-SHV01-V-113 e datës 12.07.2021, duke e detyruar debitorin që t'ia paguaj kreditorit borxhin në shumë prej 2,859.20 Euro, me kamat ligjore prej 8 %, duke filluar nga data e kalimit të afatit të pagesës së faturave e gjerë në pagesën definitive të borxhit kryesor dhe kamatës si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, duke u ekzekutuar me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe bartjen e shumës në llogarinë e veçantë të Përmbauesit Privat, si dhe regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, fillimisht të automjeteve sipas faturave dhe asete të tjera të luajtshme dhe të paluajtshme, ashtu që nga shitja e realizuar të përmbushet dhe shlyhet borxhi kryesor i debitorit, kamata ligjore si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore së bashku me tarifën e efikasiteti. Po ashtu këtë urdhër ta ekzekutoj Përmbauesi Privat dhe pagesa të bëhet në llogarinë e veçantë të Përmbauesit Privat, e më pas të transferohen në llogarinë e kreditorit në bankë përkatëse.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin përbarimor, për faktin se ky urdhër për përbarim është lëshuar në bazë të faturave të cilat janë paguar nga ana e debitorit, dhe janë paraqitur fatura të cilat faktikisht janë mbyllur, sepse debitori ka bërë pagesën e tyre në tërësi. Tutje ka theksuar se prapësimin e mbështet në nenin 67 paragrafi 4 i LPP-së, dhe pretendon se faturat në bazë të cilave është caktuar përbarimi nuk paraqesin dokument të besueshëm, siç është përcaktuar në nenin 29, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të LPP-së. Andaj nga arsyet e cekura, debitori i ka propozuar gjykatës që pas analizimit të propozimit për përbarim dhe prapësimin, të veproj sipas propozimit të debitorit të cekur si më lartë.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar prapësimin e debitorit ku theksuar se faturat i plotësojnë të gjitha kushtet dhe elementet e parapara sipas LPP-së, për më tepër faturat janë të nënshkruar dhe të vulosura nga debitori, dhe se debitori ka qenë i obliguar të njëjta t'ia shlyej (secilën veç e veç në kohën, ditën e njëjtë në të cilën janë lëshuar faturat, pra në ditën në të cilën i është kryer shërbimi debitorit. Tutje ka theksuar se përkundër email-ti njoftues që është bërë ndaj debitorit se në rast të mos shlyerjes së detyrimeve më së largu deri me datë 20.08.2021, kreditori do të kërkoj përmbushjen e detyrimeve ndaj tij përmes procedurës përbarimore, debitori nuk e ka shlyer fare borxhin, porse të njëjtin e ka shlyer siç duket vetëm pasi është njoftuar nga ana e postës pasi që Përmbauesi Privat i ka dërguar shkresat e lëndës. Andaj duke u bazuar në prova të lartpërmendura, dhe në bazë të së drejtës së garantuar përmes ligjit, kreditorit i takon kompensimi i shpenzimeve të procedurës përbarimore,

si dhe kamatë ligjore, i propozon gjykatës që ta refuzoj si të pathemeltë prapësimin e debitorit, të mbetet në fuçi Urdhri Përmbarimor, si dhe të detyrohet debitori që të ia paguaj kamatën ligjore, shpenzimet e caktuara të kreditorit si dhe shpenzimet dhe tarifën e efikasiteti sipas Udhëzimit Administrativ mbi tarifën dhe shpërblimet e Përmbaruesit Privat, pasi që është konstatuar se debitori ka paguar kreditorit vetëm borxhin kryesor, pasi caktimit të Urdhrit Përmbarimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi është pjesërisht i bazuar për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se borxhi i kërkuar nga kreditori me propozimin për përmbarim dhe i lejuar me urdhrin e Përmbaruesit Privat Rezarta Metaj P.nr.357/21 të datës 03.09.2021, është në shumën prej 2,859.20 Euro është përmbushur në tërësi.

Nga prapësimi i debitorit në të cilin është bashkangjitur edhe dëshmia e pagesë së faturave e datës 06.09.2021, gjykata është njoftuar se debitori e ka përmbushur detyrimin kryesor në shumën prej 2,859.20 Euro.

Gjykata duke u bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, përkatësisht dëshmia e pagesës së faturave e datës 06.09.2021, konstatoi se debitori e ka përmbushur detyrimin për pagesën e borxhit, në shumën prej 2,859.20 Euro, andaj vlerësoi se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar në kuptim të nenit 71 par.1 nën par.1.2, ku përcaktohet se *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues është prishur anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”* dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi që dokumenti i besueshëm - faturat në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, e ka humbur efektin, sepse e njëjta është përmbushur nga debitori.

Gjykata në kuptim të nenit 4 paragrafit 4 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, në të cilën theksohet se *“përveç tarifës së efikasitetit të përmbarimit, e cila përcaktohet me marrëveshje në mes të përmbaruesit privat dhe kreditorit, tarifën tjera paraprakisht paguhen nga kreditorit dhe pas përfundimit të*

*procedurës, ato i ngarkohen debitorit”, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, meqenëse kreditori i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës përbarimore që janë krijuar prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi, i cili është lejuar me urdhrin përbarimor të Përbaruesit Privat Rezarta Metaj, P.nr.357/21 të datës 03.09.2021. Andaj gjykata vlerësoi se shpenzimet e përbarimit janë krijuar nga ana e debitorit, pasi që i njëjti detyrimin e tij ndaj kreditorit e ka përmbushur pas inicimit të procedurës përbarimore dhe zhvillimit të procedurës deri në këtë fazë.*

Andaj nisur nga fakti se në rastin konkret debitori e ka paguar në tërësi detyrimin e tij ndaj kreditorit, si dhe duke u bazuar në nenin 66 paragrafin 4 të LPP-së i cili përcakton se: *“Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përbarimore”, dhe nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore, me të cilin përcaktohet se: “Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit, dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përbarimit si rrjedhojë e përmbushjes në tërësi të kredisë në të holla të palës kreditore, ndërsa urdhrin përbarimor e la në fuqi vetëm sa i përket pjesës së shpenzimeve të procedurës përbarimore dhe kamatës.*

Gjykata në kuptim të nenit 66 par. 4, 71 par.1, nën par. 1.2, nenit 73 par.1 dhe 3 të LPP-së nenit 4 par. 4, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.960/22, datë 17.10.2023

Gjyqtari

Gent Bkeri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.